

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Dy turiste suedeze në Tiranë: Ftuar në shtëpi 3 djem, ata na p*rdhunuan, pastaj ftuar 2 të tjerë, edhe ata na p*rdhunuan
ADRESA	https://piranjat.al/aktualitet/dy-turiste-suedeze-ne-tirane-ftuar-ne-shtepi-3-djem-ata-na-p-rdhunuan-i105022
BURIMI	piranjat.al
GJENDJA	edited

KOHA


KAPUR NGA NE	19 shtator 2026, 16:17:52 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	19 shtator 2026, 16:09:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	6cc060fa626fcf12973e30d56eeae89fdc4489bc4eb003272534545445a8036
TEKSTI	ec15bc926082a1e0e47f855ebb81584b144da8b9466febb1da3a05017f50db82
PAMJA	fd2587a8bdda0f4c3de14f2cb08bba32679ae2c64f009043a1b51df5524ea3f0

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	9ea3430867448a5110faf24cd0da5132069601f7f6f64585994d4c3812c66d36
E MËPARSHMJA	587f0203166cb86c3924bcc28c3396d56ff455faf1639d489a64d7ab7c8f50f8
RRËNJA MERKLE	—
ANKORIMI	nuk është ankoruar ende <i>Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërin nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahajo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/9ea3430867448a5110faf24cd0da5132069601f7f6f64585994d4c3812c66d36>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [EDITORIAL](#)
- [EMISIONE](#)
- [INVESTIGIME](#)
- [AKTUALITET](#)
- [SOCIALE](#)
- [POLITIKË](#)
- [KOSOVA](#)
- [BOTA](#)
- [SHOWBIZ](#)
- [LIFESTYLE](#)
- [SPORT](#)

SYRI LIVE



Flash: **Simeone përballë** sërisht në pankina, duke **Asgje nuk e nxin** komunikim në rrjetin social këtë të **Irezikshme të vendit,** se ministri i ri, "Demo **tiniandezeve** ka bërë thirrje qytetarëve **e vendimit** konflikte, përplasje e drama që **alarm r** Kishinë

AKTUALITET

Dy turiste suedeze në Tiranë: Ftuan në shtëpi 3 djem, ata na p*rdhunuan, pastaj ftuan 2 të tjerë, edhe ata na p*rdhunuan

Piranjat Përditësimi i fundit 19 Shtator 2026, 18:09



Dy turiste nga Suedia, që kishin mbërritur në Tiranë në 4 shtator 2026, pretendojnë se janë abuzuar seksualisht nga 5 djem, të cilët i kanë ftuar vetë në banesën e tyre të marrë me qira përmes sistemit "AirBNB" në kryeqytet.

Turistet kanë argumentuar në kallëzimin e tyre se abuzimi seksual ka ndodhur mes datës 5 dhe 6 shtator 2026 në Tiranë. Por siç mëson gazetari Elton Qyno, kallëzimin penal e kanë depozituar pas 3 ditësh në Policinë e Durrësit, qytet në të cilin kishin shkuar për të pushuar.

Kallëzimi i tyre më pas është transferuar nga Durrësi në komisaratin nr.3 në Tiranë, oficerët e të cilit kanë nisur verifikimin e pretendimeve të dy turistëve dhe identifikimin e 5 meshkujve që dyshohet se kanë përdhunuar turistet.

Sipas dosjes së policisë, mësohet se dy shtetaset me inicialet S.M dhe M.J, kanë mbërritur në Shqipërisë përmes aeroportit "Nënë Tereza". Ato janë vendosur për rreth dy ditë në një banesë me qira ditore të marrë në Tiranë.

Në mesnatën e 5 shtatorit, dy turistet kanë dalë në Tiranë për të ngrënë ushqim. Sipas rrëfimit të tyre, në vendin ku kanë qëndruar për të ngrënë ushqim, janë njohur me dy djem, të cilët shërbenin si shpërndarës ushqim me motor në Tiranë.

Për shkak të bisedës dhe njohjes që kanë bërë me ta, dy turistet i kanë ftuar në banesën e marrë me qira për të pirë diçka. Sipas tyre, dy djemtë që i kishin ftuar, morën me vete dhe një shokun e tyre.

"...kemi shkuar në shtëpi dhe jemi ulur të gjithë në koltukun e kuzhinës. Ne i kemi shërbyer djemve me disa pije dhe jemi ulur së bashku me ta, duke biseduar. Por njëri nga djemtë ka filluar ta ngacmojë me duar shoqen time dhe më pas ta puthë. Unë e kam marrë shoqen për dore dhe së bashku kemi hyrë në tualetin e shtëpisë, duke i thënë se mos vallë bëmë gabim që i kemi ftuar në shtëpi ata djem..." - ka treguar njëra nga shtetaset suedeze.

Por ato kanë dalë nga tualeti dhe i janë bashkuar sërisht 3 djemve. Njeri prej suedezeve ka treguar se nuk mban shumë mend se çfarë ka ndodhur me të atë natë, pasi ka qenë e dehur dhe e përgjumur. Por në kallëzim ajo kujton se ka parë shoqen e saj të shtrirë në dhomën e gjumit, me njërin nga djemtë që po abuzonte seksualisht me të.

Mirëpo kjo histori nuk ka mbaruar këtu.

Teksa 3 djemtë janë larguar, dy turistet kanë qëndruar përgjatë gjithë ditën në gjumë. Ato janë zgjuar në mesnatën e datës 6 shtator dhe të dyja së bashku kanë dalë në Tiranë për të konsumuar ushqim "Hot-Dog".

Rrugës kur po ktheheshin në shtëpi në mesnatë, dy turistet kanë njohur dy djem dhe kanë hyrë në bisedë me ta. Dy vajzat kanë pohuar se i kanë ftuar miqësisht në shtëpi dhe sërisht gjatë mesnatës dy djemtë sipas tyre, kanë abuzuar seksualisht me to.

Ditën tjetër dy turistet suedeze janë larguar nga Tiranë në qytetin e Durrësit.

Pas 3 ditësh turistet kanë shkuar në ambientet e Policisë së Durrësit, duke depozituar kallëzim penal ndaj 5 djemve shqiptarë, të cilët i kanë akuzuar për veprën penale të "Kryerjes pa dëshirë të marrëdhënieve seksuale me persona të rritur".

Duke qenë se krimi i dyshuar është kryer në Tiranë, Policia e Durrësit këtë kallëzim të bërë nga dy turistet suedeze, ia kanë dërguar Policisë së Tiranës dhe më konkretisht komisaratin nr.3 në kryeqytet.

Tashmë oficerët e këtij komisarati kanë nisur hetimet për lokalizimin dhe gjetjen e 5 djemve që dyshohet se kanë abuzuar seksualisht me 2 turistet nga Suedia. Ndërkohë për rastin në fjalë, interes për hetimin ka shfaqur dhe Ambasada Suedeze në Tiranë.

Artikuj te sugjeruar

AKTUALITET 19 Shtator17:57

[Dogji mbeturinat, banori në Durrës i vë flakën lagjes 13, zjarri pranë banesave](#)

Një zjarr ka përfshirë pasditen e sotme një sipërfaqe me bimësi në lagjen 13 të Durrësit, duke u përhapur me s...

AKTUALITET 19 Shtator17:49

[“Klienti specifik”/ Lala: Si fshihej emri i Ballukut në dosjen e vilës luksoze në Palasë](#)

Detaje të reja kanë dalë në dritë nga dosja hetimore e Prokurorisë së Posaçme (SPAK) lidhur me ish-zëvendësk...

AKTUALITET 19 Shtator17:41

[Akuzat për falsifikim të dokumenteve dhe përfitim i padrejtë i pronave, tjetër masë për ish-drejtorin e Kadastrës Fier e dy të tjerë](#)

Prokuroria e Fierit ka vijuar hetimet për një skemë të dyshuar të përfitimit dhe regjistrimit të kundërligjshëm t&e...

AKTUALITET 19 Shtator17:29

[Kakavijë/ Zbulohen steka cigare kontrabandë në autobusin Athinë-Tiranë, nisin hetimet për doganierët](#)

Krimi Ekonomik në Drejtorinë Vendore të Policisë Gjirokastër zbulon sasinë e madhe të cigareve kontrabandë fshehur n&eum...

AKTUALITET 19 Shtator17:17

[Protestë në Vlorë/ Qytetarët kundër muzeut hebraik](#)

Qytetarët e Vlorës janë ngritur sërish në protestë pranë kantierit të Muzeut Hebraik në Vlorë, duke kundë...

AKTUALITET 19 Shtator16:30

[“E godita në zemër”/ Vrau me thikë gruan, zbardhet dëshmia e Hysni Patushit](#)

68-vjeçari, Hysni Patushi i cili vrau me thikë bashkëshorten e tij, Lumturie Patushi, brenda banesës së tyre në zonën e Zog...

AKTUALITET 19 Shtator14:47

[Goditet rrjeti i kokainës në Laç/ Arrestohen dy të rinj, iu sekuestruan 80 doza gati për shitje](#)

Një tjetër goditje ndaj shpërndarjes së lëndëve narkotike është finalizuar nga Seksioni për Hetimin e Narkotik&eu...

AKTUALITET 19 Shtator13:27

[Aksident në aksin Fier-Patos/ Shpërndarësi i picave përplasat me automjetin, plagoset në këmbë](#)

Një aksident rrugor është regjistruar paraditen e sotme në aksin Fier–Patos, pikërisht në afërsi të kryqëzi...

AKTUALITET 19 Shtator13:13

[Vrau me thikë bashkëshorten, vihet në pranga 68-vjeçari](#)

Hysni Patushi, i cili mëngjesin e të shtunës vrau me thikë gruan e tij, Lumturi Patushi, është arrestuar nga Policia pak orë ...

AKTUALITET 19 Shtator12:25

[Burri vrau me thikë bashkëshorten, krimi në sy të nipit të mitur dhe dhëndrit të tyre](#)

Zbardhen të tjera detaje në lidhje me ngjarjen e rëndë që tronditi sot Tiranën, ku në rrethana të paqarta burri ka vra...

ME TE VIZITUARAT

BOTA 18 Shtator

[VIDEO dramatike/ Të dashurës i erdhi burri, i r...](#)

Ky është momenti kur një burrë, gjysmë i zhveshur, u rrëzua nga një dritare teksa tentonte të arratisej, pasi dyshohet s...

AKTUALITET 19 Shtator

[Të shtëna me armë në një kantier ndërtimi në T...](#)

Të shtëna me armë zjarri janë regjistruar në orët e para të mëngjesit në një kantier ndërtimi në T...

AKTUALITET 18 Shtator

[Kush është 42-vjeçarja nga Durrësi që u përplas...](#)


Një ngjarje tragjike ka ndodhur mëngjesin e së premtes në San Donà di Piave, pranë Venecias, ku një 42-vjeçare shqip...

INVESTIGIME 19 Shtator14:14

[Pesë muaj pa të birin/ Nëna kërkon zbatimin e vendimit të gjykatës](#)

Në shumë raste, ndarja e një çifti me fëmijë të mitur shoqërohet me konflikte, përplasje e drama që godasi...

video



PIRANJAT SHOW - SEZONI 10 EPISODI 1




PIRANJAT SHOW - SEZONI 10 EPISODI 1



"Dua 120 mijë euro"/ Si u zaptua prona në rrugën e Durrësit, zbardhet skema e mashtrimit





Tmerri i 40-vjeçares / Si u shndërrua njohja e re në përndjekje, shantazh dhe denigrim në rrjet



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.